

Rëndësia e edukimit fetar në sistemin arsimor

MA. Genti Kruja

Drejtor i Kulturës - KMSH

Abstrakt

Problemet e arsimit dhe të edukimit kanë preokupuar shumë filozofi, religjione, mendimtarë, dijetarë dhe sisteme politike në kohë dhe vende të ndryshme të botës. Edukimi dhe arsimi sot përbën një nga shtyllat kryesore të shoqërisë, ku në shumë vende dhe zona ku mungon ose keqpërdoret ajo, kemi probleme sociale, të cilat shpeshherë shkaktojnë kriza shoqërore, madje dhe konflikte e luftëra.

Kështu sot me anë të një miredukimi dhe arsimimi, ku gërshetohen shkencat ekzakte me vlerat e besimit, e sidomos me normat dhe parimet e Islamit, do të kemi një shoqëri më të shëndetshme moralisht dhe shpirtërisht, nga të cilat do të rrezatojë paqja, mirëkuptimi dhe bashkëjetesa pa dallim race, gjinie dhe feje. Ky model aktualisht aplikohet me shumë sukses në medresetë e Shqipërisë, të cilat vitet e fundit e kanë vërtetuar tezen e suksesit me anët të arritjeve dhe nivelit shumë të mirë të nxënësve të tyre.